



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Departamenti i Marketingut dhe Ixhinierisë, në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, shpall konkurs për 1 (një) pozicion pune, personel akademik me kohë të plotë, kategoria lektor:

Kandidati i kategorisë lektor, duhet të plotësojë këto kritere të përgjithshme e të veçanta:

Kritere të përgjithshme, kategoria lektor:

1. Kandidati duhet të ketë gradën doktor i shkencave në profil Marketing/Turizëm; (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njehsuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin në Shqipëri);
2. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare (Ba/Master i Shkencave) ose ekuivalente me to në fushën e shkencave ekonomike.
3. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njehsuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin në Shqipëri);
4. Kandidati duhet të ketë të paktën 2(dy) vjet përvojë pune si personel akademik;
5. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të Bashkimit Europian;
6. Ndaj kandidatit të mos ketë masë disiplinore në fuqi të largimit nga puna;
7. Kandidati të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
8. Të jetë i aftë për punë.

Kritere të veçanta, kategoria lektor:

1. Kandidati të ketë përvojë jo më pak se pesë vite në IAL në lëndë të fushës së marketingut dhe inxhinierisë, preferohet eksperiencë në ciklin e dytë të studimeve.
2. Preferohen kandidatë të cilët një nga ciklet e studimit ta kenë kryer në universitetet e huaja.
3. CV e vlerësuar në tërësinë e saj, përbën kriter preferencial.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**26.02.2024 – 06.03.2024**) nga data e shpalljes në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) dokumentacionin e kërkuar, si më poshtë:

- Formular aplikimi;
- Jetëshkrimin e tij/saj;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
REKTORI**

- Kopje e noterizuar e diplomave dhe të listave të notave. (Diplomat e lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njehsuar nga Minsitria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- Dokumentacion shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës/Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës;
- Çertifikata, kualifikime, brenda dhe jashtë vendit, të njehsuara me origjinalin;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Raport i gjendjes shëndetësore, që vërteton aftësinë për punë;
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Librezë shëndetësore

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (26.02.2024 – 06.03.2024) në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”**

**Rruga “Ismail Zyma”**

**Aplikim për pozicionin e punës:**

*Fakulteti Ekonomik*

**Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit Ekonomik. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do të nënshtohen intervistës me gojë (08.03.2024 – 27.03.2024). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.